

Emri i Lëndës : E Drejte Ndërkombëtare Publike I							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 301	B	Vjeshtë	3.00	0.00	0.00	3.00	6.00
Lektori		Sajmir Bata, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Program i Integruar					
Përshkrimi		E drejta ndërkombëtare publike përbëhet nga tërësia e zakoneve dhe normave juridike ndërkombëtare që rregullon marrëdhëniet juridiko-ndërkombëtare ndërmjet subjekteve të së drejtës ndërkombëtare. Lënda paraqet evoluimin, kuptimin, konceptet, parimet, burimet, subjektet, institucionet, institutet e të drejtës ndërkombëtare publike, etj. Rëndësi paraqesin normat jus cogens, aktet ndërkombëtare të OKB-së, si dhe aktet e tjera që mbrojnë të drejtat e njerit.					
Objektivat		Objektivat e lëndës janë që t'iu ofrojë studentëve thellim dhe zgjerim të njohurive mbi të drejtën ndërkombëtare publike dhe elementët e saj si në aspektin teorik edhe atë praktik. Gjithashtu objektivi është t'i edukojë ata në zgjidhjen e problemeve në mënyrë paqësore, duke mbrojtur liritë dhe të drejtat e njeriut.					
Konceptet Kryesore		1. E Drejta ndërkombëtare. 2. Subjekt i se drejtës ndërkombëtare. 3. Parimet, burimet, zakonet dhe normat e së drejtës ndërkombëtare. 4. Sui generis. 5. Objekt i së drejtës ndërkombëtare. 6. Sovrani i shtetit. 7. Njohja ndërkombëtare e shtetit. 8. Përgjegjësia ndërkombëtare e shtetit. 9. Të drejtat e njeriut. 10. Shtet. 11. Format e vartësisë ndërkombëtare. 12. Institucione dhe institute ndërkombëtare. 13. Jus cogens. 14. Gjtykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. 15. Akte juridike ndërkombëtare.					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Fillesat dhe evoluimi historik i të drejtës ndërkombëtare publike. Studentët do të njihen me mënyrën dhe formën e leksioneve, detyrimet e frekuentimit, përmbajtjen dhe literaturën rreth lëndës, si dhe formën e vlerësimit. Tema trajton pikëpamjet lidhur me origjinën e të drejtës ndërkombëtare publike dhe evoluimin e saj në etapat e ndryshme historiko-juridike. Literatura përkatëse: 1) Malcolm D. Evans, International Law, Oxford University Press; Sixth edition (September 25, 2024), Part I. The History and Theory of International Law. 2) Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë, Botimet Dudaj, 2010, fq. 34-46, 52-54, 58-69, 70-79, 83-88. 3) Zejnullah Gruda, E Dejta Ndërkombëtare Publike, Prishtinë, Universiteti i Prishtinës, 2013, fq. 24-54.						
2	Objekti dhe karakteristikat e të drejtës ndërkombëtare publike, dhe dallimi me degët e tjera të së drejtës. Tema paraqet dhe analizon objektin e të drejtës ndërkombëtare publike, karakteristikat kryesore të saj, si dhe jepen dallimet e kësaj dege të së drejtës me degët e tjera juridike. Literatura përkatëse: 1) Jan Klabbers, International Law, Cambridge University Press; 4th edition (Janary 11, 2024), p. 3-22. 2) Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë, Botimet Dudaj, 2010, fq. 5-12, 32-33. 3) Zejnullah Gruda, E Dejta Ndërkombëtare Publike, Prishtinë, Universiteti i Prishtinës, 2013, fq. 3-19.						

3	Institutet dhe institucionet juridike ndërkombëtare. Tema trajton institutet dhe institucionet e të drejtës ndërkombëtare publike sipas përmbajtjes dhe rëndësisë së tyre. Institucionet që trajton ndër të tjera janë: Lidhja e Kombeve, Organizata e Kombeve të Bashkuara, institucionet gjyqësore ndërkombëtare, etj. Tema analizon gjithashtu edhe kodifikimin e të drejtës ndërkombëtare. Literatura përkatëse: 1) Jan Klabbers, International Law, Cambridge University Press; 4th edition (January 11, 2024), p. 153-180. 2) Malcolm N. Shaw, International Law, Cambridge University Press, 9th edition (September 23, 2021), p. 1133-1176. 3) Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë, Botimet Dudaj, 2010, fq. 22-27, 36-43, 46-52, 55-58, 69-70, 470-503. 4) Zejnullah Gruda, E Dejta Ndërkombëtare Publike, Prishtinë, Universiteti i Prishtinës, 2013, fq. 64-69, 345-417.
4	Natyrë e të drejtës ndërkombëtare dhe raporti i saj me të drejtën e brendshme shtetërore. Tema trajton natyrën, rolin, rëndësinë, dhe zbatueshmërinë e të drejtës ndërkombëtare si sistem juridik. Gjithashtu argumenton veprimin e normës ndërkombëtare në sferën e brendshme, dhe detyrueshmërinë e disa normave të së drejtës ndërkombëtare. Literatura përkatëse: 1) Malcolm N. Shaw, International Law, Cambridge University Press, 9th edition (September 23, 2021), p. 1-36. 2) Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare, Tiranë, AiiS, 2011, fq. 35-61. 3) Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë, Botimet Dudaj, 2010, 12-15, 26-32. 4) Zejnullah Gruda, E Dejta Ndërkombëtare Publike, Prishtinë, Universiteti i Prishtinës, 2013, fq. 19-24.
5	Burimet e të drejtës ndërkombëtare publike. Tema trajton nocionin, kategorinë dhe elementët e burimeve të së drejtës ndërkombëtare publike (traktatin, zakonin, parimet e përgjithshme të së drejtës, vendimet gjyqësore, vendimet e organizatave ndërkombëtare, normat e buta juridike, doktrinën dhe jurisprudencën). Literatura përkatëse: 1) Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare, Tiranë, AiiS, 2011, fq. 61-97. 2) Malcolm N. Shaw, International Law, Cambridge University Press, 9th edition (September 23, 2021), p. 58-110. 3) Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë, Botimet Dudaj, 2010, 15-26. 4) Zejnullah Gruda, E Dejta Ndërkombëtare Publike, Prishtinë, Universiteti i Prishtinës, 2013, fq. 54-64.
6	Subjektet e të drejtës ndërkombëtare publike. Tema jep përkufizimin e termit subjekte ndërkombëtare, analizon llojet dhe karakteristikat e tyre, si dhe argumenton statusin, rëndësinë, të drejtat dhe detyrimet që kanë këto subjekte. Literatura përkatëse: 1) Jan Klabbers, International Law, Cambridge University Press; 4th edition (January 11, 2024), p. 71-98. 2) Malcolm D. Evans, International Law, Oxford University Press; Sixth edition (September 25, 2024), Part III. The Subjects of the International Legal Order. 3) Malcolm N. Shaw, International Law, Cambridge University Press, 9th edition (September 23, 2021), p. 179-242. 4) Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare, Tiranë, AiiS, 2011, fq. 169-172. 5) Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë, Botimet Dudaj, 2010, fq. 89-103. 6) Montevideo Convention on the Rights and Duties of States 1933. 7) Zejnullah Gruda, E Dejta Ndërkombëtare Publike, Prishtinë, Universiteti i Prishtinës, 2013, fq. 59-78.
7	Sovraniteti shtetëror sipas të drejtës ndërkombëtare. Tema paraqet kuptimin dhe tiparet e sovranitetit shtetëror sipas të drejtës ndërkombëtare publike. Argumenton rëndësinë dhe llojet e sovranitetit (sovraniteti i kufizuar i shtetit, sovraniteti territorial, pavarësia), etj. Literatura përkatëse: 1) Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë, Botimet Dudaj, 2010, fq. 103-111. 2) Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare, Tiranë, AiiS, 2011, fq. 221-225. 3) Malcolm D. Evans, International Law, Oxford University Press; Sixth edition (September 25, 2024), Part IV. The Scope of Sovereignty.
8	Format e vartësisë juridike ndërkombëtare dhe privilegjet e posaçme. Tema trajton kuptimin, elementët dhe format e vartësisë juridike ndërkombëtare (vasalitetin, protektoratin, regjimin e kapitulacioneve, mandatin ndërkombëtar dhe kujdestarinë ndërkombëtare). Ndërsa tek privilegjet e posaçme trajtohen kapitulacionet. Literatura përkatëse: 1) Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë, Botimet Dudaj, 2010, fq. 111-130. 2) Zejnullah Gruda, E Dejta Ndërkombëtare Publike, Prishtinë, Universiteti i Prishtinës, 2013, fq. 128-136.
9	Provim gjysmë-final.
10	Format e bashkimit dhe ndarjes së shteteve sipas të drejtës e praktikës ndërkombëtare, dhe statusi juridik i tyre. Tema analizon format e bashkimit të shteteve si: Bashkimi Personal, Bashkimi Real, Konfederata, Federata, Komenuelthi, Komuniteti (Bashkimi Europian), Këshilli i Europës, mikroshtetet, etj. Këtu trajtohen edhe shtetet me status të diskutueshëm. Literatura përkatëse: 1) Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë, Botimet Dudaj, 2010, fq. 130-166. 2) Zejnullah Gruda, E Dejta Ndërkombëtare Publike, Prishtinë, Universiteti i Prishtinës, 2013, fq. 121-128.

11	Rëndësia e njohjes ndërkombëtare për shtetin dhe qeverinë. Tema trajton kuptimin dhe rëndësinë e njohjes ndërkombëtare për një shtet dhe qeveri, teoritë e njohjes, mënyrat dhe format e njohjes, si dhe dallimi midis njohjes ndërkombëtare të shtetit dhe të qeverisë (duke përfshirë edhe shtetin shqiptarë). Literatura përkatëse: 1) Malcolm N. Shaw, International Law, Cambridge University Press, 9th edition (September 23, 2021), p. 377-416. 2) Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë, Botimet Dudaj, 2010, fq. 167-190. 3) Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare, Tiranë, AiiS, 2011, fq. 177-178, 186-192, 201. 4) Montevideo Convention on the Rights and Duties of States 1933. 5) Zejnullah Gruda, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Prishtinë, Universiteti i Prishtinës, 2013, fq. 78-92.
12	Parimet, llojet dhe elementët e juridiksionit shtetëror. Tema trajton nocionin e juridiksion shtetëror, analizon parimet dhe llojet e juridiksionit (territorial, i shtetësisë, i gjithmbarshëm, i mbrojtjes, pasiv, mbi personat e kapur në shkelje të së drejtës ndërkombëtare, etj). Literatura përkatëse: 1) Jan Klabbbers, International Law, Cambridge University Press; 4th edition (January 11, 2024), p. 98-117. 2) Malcolm N. Shaw, International Law, Cambridge University Press, 9th edition (September 23, 2021), p. 555-651. 3) Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare, Tiranë, AiiS, 2011, fq. 205-219. 4) Zejnullah Gruda, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Prishtinë, Universiteti i Prishtinës, 2013, fq. 102-121.
13	Përgjegjësia e organizatave ndërkombëtare dhe shtetit sipas të drejtës ndërkombëtare. Tema trajton kuptimin, lindjen, tiparet e përgjegjësisë së organizatave ndërkombëtare dhe shteteve, si dhe çështjet e përgjithshme, llojet, subjektet, pasojat dhe shpërblimin e dëmeve që rrjedhin nga mosrespektimi i përgjegjësisë. Literatura përkatëse: 1) Jan Klabbbers, International Law, Cambridge University Press; 4th edition (January 11, 2024), p. 136-153, 180-199. 2) Malcolm N. Shaw, International Law, Cambridge University Press, 9th edition (September 23, 2021), p. 677-739. 3) Malcolm D. Evans, International Law, Oxford University Press; Sixth edition (September 25, 2024), Part V. Responsibility. Part VI Responding to Breaches of International Obligations. 4) Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare, Tiranë, AiiS, 2011, fq. 324-363. 5) Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë, Botimet Dudaj, 2010, fq. 190-209. 6) Zejnullah Gruda, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Prishtinë, Universiteti i Prishtinës, 2013, fq. 136-159.
14	Rëndësia e akteve, vendimeve dhe veprimeve juridike ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Tema paraqet kuptimin e të drejtave të njeriut, zhvillimin historik të akteve, vendimeve dhe veprimeve që lidhen me këto të drejta, analizon sistemet e ndryshme të të drejtave të njeriut (të OKB-së, Bashkimit Europian dhe OSBE-së, sistemin amerikan, afrikan, etj). Trajtohen vendimet e gjykatave, dhe veprimet e organeve ndërkombëtare, në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Literatura përkatëse: 1) Jan Klabbbers, International Law, Cambridge University Press; 4th edition (January 11, 2024), p. 117-136, 335-347. 2) Malcolm N. Shaw, International Law, Cambridge University Press, 9th edition (September 23, 2021), p. 242-329. 3) Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë, Botimet Dudaj, 2010, fq. 209-236. 4) Zejnullah Gruda, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Prishtinë, Universiteti i Prishtinës, 2013, fq. 417-447. 5) Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare, Tiranë, AiiS, 2011, fq. 442-463.
15	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe dobësitë e të drejtës ndërkombëtare publike. Tema trajton rëndësinë e mjeteve paqësore për zgjidhjen e masmarrëveshjeve ndërkombëtare në rrugë paqësore. Analizohen mjetet ekstra juridike si: bisedimet, shërbimet e mira, ndërmjetësimi, hetimet (anketa), pajtimi, si dhe mjetet gjyqësore: Arbitrazhi, Gjykata ndërkombëtare. Literatura përkatëse: 1) Malcolm D. Evans, International Law, Oxford University Press; Sixth edition (September 25, 2024), Part VII. The Application of International Law. 2) Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare, Tiranë, AiiS, 2011, fq. 363-404. 3) Zejnullah Gruda, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Prishtinë, Universiteti i Prishtinës, 2013, fq. 475-525.
16	Provim Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• 1) Malcolm D. Evans, International Law, Oxford University Press; Sixth edition (September 25, 2024). • 2) Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë, Botimet Dudaj, 2010. • 3) Zejnullah Gruda, E Dejta Ndërkombëtare Publike, Prishtinë, Universiteti i Prishtinës, 2013. • 4) Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare, Tiranë, AiS, 2011.
Referenca të tjera	• 1) Jan Klabbers, International Law, Cambridge University Press; 4th edition (January 11, 2024). • 2) Ilias Bantekas and Lutz Oette, International Human Rights Law and practice, Cambridge University Press; 4th edition (February 15, 2024). • 3) Daniel Moeckli, Sangeeta Shah & Sandesh Sivakumaran, International Human Rights Law, Oxford University Press; 4th edition (October 31, 2022). • 4) Malcolm N. Shaw, International Law, Cambridge University Press, 9th edition (September 23, 2021). • 5) Jack Donnelly and Daniel J. Whelan, International Human Rights, Routledge; 6th edition (June 16, 2020). • 6) Valerie Epps, John Cerone, Brad R. Roth, International Law, Carolina Academic Press; Sixth edition (August 1, 2019). • 7) Sean D. Murphy, Principles of International Law, West Academic Publishing; 3rd edition (August 20, 2018). • 8) Xhezair Zaganjori, Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare, Tiranë, Shkolla e Magjistraturës, 2012. • 9) Karta e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (1945). • 10) Statuti i Aktualizuar i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë 1993 (me ndryshime). • 11) Statuti i Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare (1998). • 12) Deklarata e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut (1948). • 13) Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (1950). • 14) Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1976). • 15) Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (1976). • 16) Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian (2007). • 17) Konventa mbi të drejtat e fëmijës (OKB) 1989. • 18) Konventa për Zgjidhjen Paqësore të Mosmarrëveshjeve Ndërkombëtare (1907). • 19) Konventa Ndërkombëtare për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukja me forcë (2006). • 20) Konventa në lidhje me Statusin e Personave pa Shtetësi (1954). • 21) Rregullorja e Procedurës dhe e Provave (OKB), e Tribunalit Ndërkombëtar për territorin e ish-Jugosllavisë, 11 shkurt 1994 (e ndryshuar).
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Në përfundim të lëndës “E drejtë Ndërkombëtare Publike I”, studentët do të dinë nocionet themelore të së drejtës ndërkombëtare publike.
2	Studentët do të analizojnë parimet, burimet, institutet, dhe institucionet e të drejtës ndërkombëtare publike.
3	Studentët do të argumentojnë dallimin midis të drejtës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare publike.
4	Studentët do të kuptojnë procesin e krijimit dhe funksionimit të shtetit sipas të drejtës ndërkombëtare, si dhe rëndësinë e sovranitetit e njohjes ndërkombëtare për një shtet.
5	Studentët do të argumentojnë dhe analizojë rëndësinë e të drejtave të njeriut.
6	Studentët do të zotërojnë terminologjinë juridike rreth lëndës.
7	Studentët do të kenë njohuri të gjëra rreth të drejtës ndërkombëtare publike.
8	Studentët do të analizojnë format e vartësisë juridike ndërkombëtare, etj.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	20	
Kuize	0	0	
Projekte	1	20	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	1	10	10
Gjysmë finale	1	15	15
Provimi final	1	21	21
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			150
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.00
ECTS			6.00